



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, 14 nëntor 2014
Nr. ref.: RK727/14

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

Rastin Nr. KI20/14

Parashtrues

Musa Gjetaj

Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, CA. Nr. 2976/2013, të 5 dhjetorit 2013

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, kryetar
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Kadri Kryeziu, gjyqtar, dhe
Arta Rama-Hajrizi, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është parashtruar nga z. Musa Gjetaj nga Ferizaj (në tekstin e mëtejme: parashtruesi), i cili përfaqësohet nga z. Bashkim Latifi, avokat nga Prishtina.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi konteston aktgjykimin e Gjykatës së Apelit të Kosovës, CA. Nr. 2976/2013, të 5 dhjetorit 2013, i cili i është dorëzuar parashtruesit më 17 janar 2014.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së aktgjykimit të kontestuar i cili pretendohet të ketë shkelur të drejtat e tij të garantuara me Kushtetutën e Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta), përkatësisht nenin 3 [Barazia Para Ligjit], nenin 22 [Zbatimi i Drejtpërdrejtë i Marrëveshjeve dhe Instrumenteve Ndërkombëtare], nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], paragrafi 1, nenin 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave], nenin 55 [Kufizimi i të Drejtave dhe Lirive Themelore], paragrafi 4, nenin 102 [Parimet e Përgjithshme të Sistemi Gjyqësor].

Baza juridike

4. Kërkesa bazohet në nenin 113 (7) të Kushtetutës, në nenin 47 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejme: Ligji) dhe në rregullin 56 të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

5. Më 5 shkurt 2014, parashtruesi e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese.
6. Më 6 mars 2014, Kryetari, me Vendimin nr. GJR. KI20/14, caktoi gjyqtarin Kadri Kryeziu gjyqtar raportues. Të njëjtën ditë me Vendimin nr. KSH KI20/14, Kryetari caktoi Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Robert Carolan (kryesues), Almiro Rodrigues dhe Ivan Čukalović.
7. Më 13 mars 2014, Gjykata e njoftoi parashtruesin për regjistrimin e kërkesës dhe i kërkoi atij të dorëzoi autorizimin për përfaqësim për z. Bashkim Latifi. Të njëjtën ditë, Gjykata i dërgoi Gjykatës Supreme një kopje të kërkesës.
8. Më 16 mars 2014, parashtruesi e dorëzoi në Gjykatë dokumentin e kërkuar.
9. Më 15 shtator 2014, Kryetari i Gjykatës, zëvendësoi gjyqtarin Robert Carolan me gjyqtaren Arta Rama-Hajrizi, si anëtare të Kolegjit shqyrtues.
10. Më 15 shtator 2014, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

11. Parashtruesi është mësimdhënës me kontratë të përhershme në një shkollë filllore në Dobrixhë, Komuna e Gjakovës.

12. Në zgjedhjet lokale, të mbajtura në nëntor të vitit 2007, parashtruesi ka kandiduar për një post publik. Gjatë periudhës kur ai ishte në fushatë, Drejtoria e Arsimit në Komunën e Gjakovës ia ka ndalur pagën si mësimdhënës.
13. Si rezultat, parashtruesi parashtrroi padi në Gjykatën Komunale në Gjakovë, ku kërkoi kompensim për punën që kishte kryer si mësimdhënës, gjatë kohës në të cilën bënte fushatë për zgjedhjet lokale. Përfaqësuesi i parashtruesit e mbështeti padinë e parashtruesit përpara Gjykatës Komunale, duke argumentuar:

“[...] Paditësi ka qenë në marrëdhënie pune në kohë të pacaktuar si mësimdhënës [...]. Gjatë gjithë kohës së fushatës parazgjedhore, paditësi me rregull ka punuar. [...] Të paditurat pa të drejtë ia kanë ndal paditësit mjetet për punën e kryer gjatë fushatës parazgjedhore (muajin nëntor dhe dhjetë ditët e para të muajit dhjetor 2007)”.

14. Më 20 qershor 2013, Gjykata Komunale (Aktgjykimi C. nr. 58/08) e refuzoi kërkesën e parashtruesit si të pabazuar. Gjykata Komunale vërtetoi:

“[...] Gjykata bëri nxjerrjen e provave ku pas vlerësimit veç e veç të tyre dhe në lidhshmërinë e tyre reciproke, [...] gjeti se kërkesëpadia është e pabazuar dhe u refuzua.

Udhëzimi Administrativ MAPL-nr. 2007/07 MAPL për përkufizimin e veprimtarisë politike të shërbyesve civil komunal datë 05 shtator 2007, [...] Neni 6 përcakton se shërbyesit civil komunal kur paraqesin kandidaturën për ndonjë funksion të zgjedhur publik ai ose ajo duhet të marrin pushim pa pagesë 15 ditë para fushatës parazgjedhore, me qëllim që të lirohen nga përgjegjësitë dhe obligimet në shërbimin civil komunal. Neni 9 përcakton se shërbyesit civil komunal të cilët kandidojnë për ndonjë funksion publik, kanë të drejtë të kthehen në punën e tyre brenda 1 (një) jave nga data e shpalljes zyrtare të rezultateve të zgjedhjeve, në rast të mos zgjedhjes për postin publik në të cilin kanë kandiduar.

[...]

Bazuar në provat e administruara rezulton se kërkesëpadia e paditësit është e pabazuar, edhe përkundër faktit se paditësi ka punuar në mënyrë të rregullt gjatë periudhës për të cilën kërkohet pagesa e të ardhurave personale”.

15. Parashtruesi ka ushtruar ankesë në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, për shkak të “shkeljes së dispozitave të procedurës kontestimore, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale”.
16. Më 5 dhjetor 2013, Gjykata e Apelit (Aktvendimi CA. Nr. 2976, 2013) e refuzoi kërkesën e parashtruesit si të pabazuar dhe pranoi aktgjykimin e Gjykatës Komunale.
17. Gjykata e Apelit konstatoi:

“Nuk ka shkelje të nenit 182.2(n) për të cilin tregohet në ankesë, sepse dispozitivi i aktgjykimit është i qartë dhe në pajtim me provat në lëndë. Me fjalë të tjera, nga shkresat e lëndës si e pakontestueshme rezulton se paditësi si arsimtar në Shkollën fillore [...] ka konkurruar për funksionin publik në zgjedhje të 17 nëntorit 2007. Si kandidat në zgjedhje paditësi është dashur ta respektojë Udhëzimin administrativ nr. 2007/10 të cilin e ka nxjerrë Ministria e Administratës Lokale (në tekstin e mëtejme: MAPL), si dhe lajmërimin e Ministrisë së Shërbimeve Publike. Me aktet e përmendura është paraparë që kandidatët të cilët marrin pjesë në aktivitetet parazgjedhore është dashur të marrin pushim pa pagesë dhe atë nga dita e publikimit të kandidaturës.

Ky akt përdoret në tërë territorin e Kosovës dhe komunat nuk guxojnë të bëjnë përjashtim dhe të nxjerrin vendime të kundërta. Udhëzimi administrativ rregullon rregullat e sjelljes së kandidatëve për kohën e fushatës parazgjedhore në të gjitha komunat e Kosovës. Kandidati i cili ka paraqitur kandidaturën është dashur t'i përmbahet rregullave të parapara”.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

18. Parashtruesi pretendon se Gjykata e Apelit, duke ia refuzuar ankesën kundër aktgjykimit të Gjykatës Komunale, ia ka shkelur të drejtat e garantuara me Kushtetutë, konkretisht, nenin 3 [Barazia Para Ligjit], nenin 22 [Zbatimi i Drejtpërdrejtë i Marrëveshjeve dhe Instrumenteve Ndërkombëtare], nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], paragrafi 1, nenin 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave], nenin 55 [Kufizimi i të Drejtave dhe Lirive Themelore], paragrafi 4, nenin 102 [Parimet e Përgjithshme të Sistemi Gjyqësor]. Për më tepër, parashtruesi pretendon se i janë shkelur të drejtat e garantuara me nenin 23, paragrafi 2 i Deklaratës Universale për të Drejtat e Njeriut. Parashtruesi gjithashtu pretendon se i janë shkelur të drejtat e mbrojtura nga Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut dhe protokollat e saj, pa specifikuar asnjë nen të këtij instrumenti.
19. Parashtruesi pretendon se “Gjykata e shkallës së parë dhe ajo e apelit me rastin e marrjes së vendimeve - aktgjyqimeve kontestues, kanë bërë shkelje të dispozitave të procedurës kontestimore e sanksionuar nga neni 182,1 lidhur me dispozitën e nenit 183 dhe 182.1 (n) [...]”.
20. Parashtruesi gjithashtu pretendon se “Gjykata e Apelit nuk e vlerësoj asnjë fakt e paraqitur në ankesë, e cila ka për obligim konform dispozitës së nenit 204 të LPK-se me të cilën është paraparë që gjykata e shkallës së dytë më arsyetimin e aktgjykimit, gjegjësisht të aktvendimit, gjykata e shkallës së dytë duhet t'i vlerësojë thëniet në ankesë që kanë qenë të rëndësishme vendimtare për dhënien e vendimit të saj. Prandaj, gjykata është dashur të gjykoj duke e respektuar hierarkinë e akteve juridike e cila përcaktohet me dispozitën e nenit 22 të Kushtetutës [...]”.

21. Duke iu referuar nenit 23, paragrafi 3, të Deklaratës Universale për të Drejtat e Njeriut, parashtruesi më tutje pretendon se “gjykatat ia kanë mohuar të drejtën e tij për shpërblim për punën e kryer”.

22. Në fund, parashtruesi kërkoi që Gjykata:

“[...] t’i vlerësoj shkeljet nga autoritet publike sipas aktgjykimeve të Gjykatës Themelore në Gjakovë C. nr. 56/208, dt. 20.06.2013 dhe Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit në Prishtinë AC. nr. 2976/2013, dhe të njëjtit të anulohen si jo kushtetuese dhe jo ligjore”.

Pranueshmëria e kërkesës

23. Gjykata shqyrton nëse parashtruesi i ka përmbushur kushtet e nevojshme të pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tutje me Ligj dhe me Rregullore të punës.

24. Në këtë drejtim, neni 113 (1) dhe (7) i Kushtetutës parasheh:

*“1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.
[...]*

7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.”

25. Përveç kësaj, neni 49 i Ligjit parasheh se “Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajve. Afati fillon të ecë që nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor”.

26. Në këtë rast, Gjykata vëren se parashtruesi ka kërkuar ndihmë për të mbrojtur të drejtat e tij në Gjykatën Komunale dhe Gjykatën e Apelit. Gjykata e Apelit ishte shkalla e fundit në të cilën parashtruesi ka mundur të kërkojë zgjidhje, duke pasur parasysh se vlera e kontestit civil ka qenë nën 3,000.00 €. Gjykata vëren gjithashtu se parashtruesit i është dorëzuar Aktgjykimi i Gjykatës së Apelit më 17 janar 2014 dhe ai e ka parashtruar kërkesën e tij në Gjykatë më 5 shkurt 2014.

27. Prandaj, Gjykata konsideron se parashtruesi është palë e autorizuar, se i ka shteruar të gjitha mjetet juridike në dispozicion me ligjin e aplikueshëm dhe se kërkesa është dorëzuar brenda afatit prej 4 (katër) muajve.

28. Megjithatë, në vlerësimin e saj të mëtejme të pranueshmërisë së kërkesës, Gjykata i referohet gjithashtu rregullit 36 (1) c) dhe 36 (2) b) të Rregullores së punës, të cilët parashohin se:

“(1) Gjykata mund t’i shqyrtojë kërkesat vetëm nëse: (c) kërkesa nuk është qartazi e bazuar.

“(2) Gjykata do të refuzojë një kërkesë si qartazi të pabazuar, nëse bindet se:

[...], ose

b) faktet e paraqitura në asnjë mënyrë nuk e arsyetojnë pretendimin për shkeljen e një të drejte kushtetuese;

[...]

29. Siç është cekur më lart, parashtruesi ka kontestuar Aktgjykimin e Gjykatës Komonale para Gjykatës së Apelit për shkelje të ligjit të procedurës kontestimore, konstatim të gabuar të gjendjes faktike dhe aplikim të gabuar të së drejtës materiale.
30. Përderisa, pranë Gjykatës Kushtetuese, parashtruesi pretendon shkelje të të drejtave të tij të garantuara me Kushtetutë për sa i përket barazisë para ligjit, aplikimit direkt të marrëveshjeve dhe të instrumenteve ndërkombëtare, të drejtës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, të aplikimit të drejtpërdrejtë të marrëveshjeve dhe të instrumenteve ndërkombëtare, të mbrojtjes gjyqësore të të drejtave të tij, të kufizimit të të drejtave dhe lirive themelore, si dhe të parimeve të përgjithshme të sistemit gjyqësor.
31. Gjykata vëren se në procedurën e apelit, Gjykata e Apelit, lidhur me kërkesën e parashtruesit për kompensimin e të ardhurave personale, e arsyetoi aktgjykimin e saj duke iu referuar dispozitave të ligjit në fuqi. Në këtë drejtim, Gjykata gjen se ajo që ngre parashtruesi është çështje e ligjshmërisë dhe jo e kushtetutshmërisë.
32. Në lidhje me këtë, Gjykata rikujton arsyetimin e Gjykatës së Apelit duke iu përgjigjur pretendimit të parashtruesit për shkelje të ligjit dhe shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, të cilat pretendohet të jenë kryer nga Gjykata e Apelit kur ia refuzoi kërkesën për kompensimin e të ardhurave personale. Gjykata e Apelit ka deklaruar:

“[...] Duke ekzaminuar aktgjykimin e atakuar në kufijtë e pretendimeve të përmendura në ankesë, kjo gjykatë gjeti se i njëjti është nxjerrë pa shkelje thelbësore të procedurës kontestimore, me vërtetim të drejtë të gjendjes faktike dhe me zbatim të së drejtës materiale, andaj gjykata e shkallës së parë ka vendosur drejt kur e ka refuzuar kërkesëpadinë si të pabazuar”.
33. Në këtë drejtim, Gjykata thekson se nuk është detyrë e Gjykatës Kushtetuese që të merret me gabimet e faktit ose të ligjit (ligjshmërisë) që pretendohet të jenë kryer nga ana e Gjykatës Supreme, përveç nëse ato kanë shkelur të drejtat dhe liritë e mbrojtura me Kushtetutë (kushtetutshmërinë).
34. Gjykata Kushtetuese rithekson më tej se në bazë të Kushtetutës nuk është detyrë e saj të veprojë si gjykatë e shkallës së katërt, lidhur me vendimet e nxjerra nga gjykatat e rregullta. Roli i gjykatave të rregullta është t'i interpretojnë dhe zbatojnë rregullat përkatëse të së drejtës procedurale dhe materiale (shih *Garcia Ruiz kundër Spanjës*, Nr. 30544/96, GJEDNJ, Aktgjykim i 21 janarit 1999; shih, gjithashtu, edhe rastin KI70/11, të parashtruesve *Faik Hima, Magbule Hima dhe Bestar Hima*, Gjykata Kushtetuese, Aktvendimi për Papranueshmëri i 16 dhjetorit 2011). Fakti i

thjeshtë se parashtruesi është i pakënaqur me rezultatin e rastit, nuk mund t'i shërbejë atij si e drejtë për të ngritur një kërkesë të argumentueshme për shkelje të të drejtave të tij, të mbrojtura me Kushtetutë. Gjykata vëren se parashtruesit i është ofruar mundësia e mjaftueshme për ta paraqitur rastin para gjykatave të rregullta.

35. Gjykata Kushtetuese vetëm mund të shqyrtojë nëse provat janë paraqitur në mënyrë të rregullt dhe nëse procedurat në përgjithësi, shikuar në tërësinë e tyre, janë zhvilluar në mënyrë të tillë që parashtruesi të ketë pasur gjykim të drejtë (shih, *inter alia*, Raportin e Komisionit Evropian për të Drejtat e Njeriut në rastin *Edwards kundër Mbretërisë së Bashkuar*, Kërkesa nr. 13071/87, të miratuar më 10 korrik 1991).
36. Në lidhje me këtë, Gjykata vëren se arsyetimi që i referohet kërkesës për kompensimin e të ardhurave personale në aktgjykimin e Gjykatës së Apelit është i qartë dhe, pasi i ka shqyrtuar të gjitha procedurat, Gjykata ka gjetur gjithashtu se procedurat në Gjykatën Komunale nuk kanë qenë të padrejta apo arbitrare (shih *Shub kundër Lituanisë*, nr. 17064/06, GJEDNJ, Vendim i 30 qershorit 2009).
37. Për arsytet e mësipërme, Gjykata konsideron se faktet e paraqitura nga parashtruesi në asnjë mënyrë nuk e arsyetojnë pretendimin për shkeljen e të drejtave kushtetuese në të cilat thirret parashtruesi.
38. Rrjedhimisht, kërkesa është qartazi e pabazuar dhe duhet të deklarohet e papranueshme, në pajtim me rregullin 36 (1) c) dhe 36 (2) b) të Rregullores së punës.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese në pajtim me nenin 113 (7) të Kushtetutës, me nenin 47 të Ligjit dhe me rregullat 36 (1) c), 36 (2) b) dhe 56 (2) të Rregullores së punës, më 15 shtator 2014, njëzëri

VENDOS

- I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;
- III. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;
- IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues


Kadri Kryeziu

Kryetari i Gjykatës Kushtetuese


Prof. dr. Enver Hasani

